



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E SHËNDETËSISË  
DHE MBROJTJES SOCIALE  
INSTITUTI I SHËNDETT PUBLIK  
DREJTORIA

Nr. 392 prot.

Tiranë, më 02.04.2024

**URDHËR**

Nr. 100 Datë 02/04/2024

**PËR**

**“MIRATIM TË KODIT ETIK TË INSTITUTIT TË SHËNDETT PUBLIK”**

Në mbështetje të:

- Ligjit Nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar,
- Ligjit Nr.9131, datë 8.9.2003 “Për Rregullat e Etikës në Administratën Publike”,
- VKM-së Nr.874, datë 29.9.2021 “Për miratimin e rregullave për zbatimin e parimeve të Etikës, të klasifikimit të veprimtarive të jashtme dhe vlerën e dhuratave, që mund të pranohen gjatë veprimtarisë së nëpunësit të administratës publike”.

**URDHËROJ:**

1. Miratimin e Kodit Etik të Institutit të Shëndetit Publik.
2. Ngarkohet për zbatimin e Kodit të Etikës të gjithë punonjësit e Institutit të Shëndetit Publik.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**DREJTOR**

Eugena TOMINI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE  
INSTITUTI I SHËNDETIT PUBLIK

MIRATOI  
DREJTOR  
EUGENA TOMINI




# KODI I ETIKËS I INSTITUTIT TË SHËNDETIT PUBLIK

## KODI I ETIKËS

### INSTITUTI I SHËNDETIT PUBLIK

#### Parimet e Praktikës Etike në Shëndetin Publik

- a) Shëndeti publik duhet të angazhohet në parim me shkaqet themelore të sëmundshmërisë dhe kërkesat për shëndet, me synim parandalimin e efekteve të padëshirueshme shëndetësore.
- b) Shëndeti publik duhet të përfshijë shëndetin komunitar në mënyrë që t'i respektojë të drejtat e individëve në komunitet.
- c) Politikat e shëndetit publik, programet dhe prioritetet duhet të zhvillohen dhe vlerësohen nëpërmjet proceseve që sigurojnë një mundësi për pjesëmarrje nga anëtarët e komunitetit.
- d) Shëndeti publik duhet të mbrojtë ose të punojë për fuqizimin e mos heqjes të së drejtave të anëtarëve të komunitetit, duke siguruar burimet bazë dhe kushtet e nevojshme për shëndetin të jenë të aksesueshme për të gjithë njerëzit në komunitet.
- e) Shëndeti publik duhet të kërkojë informacionin e nevojshëm për të implementuar politikat dhe programet efektive për të mbrojtur dhe promovuar shëndetin.
- f) Institucionet e shëndetit publik duhet të sigurojnë komunitetet me informacionin që ata kanë nevojë për vendimmarrje mbi politikat ose programet dhe duhet të fitojnë pëlqimin e komunitetit për implementimin e tyre.
- g) Institucionet e shëndetit publik duhet të veprojnë në kohë mbi informacionin që ata kanë brenda burimeve të disponueshme dhe mandatit të dhënë atyre nga publiku.
- h) Programet dhe politikat e shëndetit publik duhet të përfshijnë përfaqje të ndryshme dhe të mirëpresin e respektojnë vlerat, besimet dhe kulturat e ndryshme në komunitet.
- i) Programet dhe politikat e shëndetit publik duhet të implementohen në mënyrë që të përmirësojë mjedisin fizik dhe social akoma më tepër.
- j) Institucionet e shëndetit publik duhet të mbrojnë konfidencialitetin e informacionit që mund të sjellë dëme për individin ose komunitetin nëse bëhet publik. Përgjashtimet mund të justifikohen mbi bazat kur interesi publik mbizoteron mbi atë privat.
- k) Institucionet e shëndetit publik duhet të sigurojnë kompetenca profesionale të punonjësve të tyre.
- l) Institucionet e shëndetit publik dhe punonjësit e tyre duhet të përfshihen në bashkëpunime dhe anëtarësime në mënyra që ndërtojnë besimin publik dhe efektivitetin e institucionit.

 1

## KODI I ETIKËS

Punonjësit e ISHP-së duhet të respektojnë Kodin e Punës dhe Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë si dhe Ligjin nr. 9131 datë 08.09.2003 “Për Rregullat e Etikës në Administratën Publike” si edhe Ligjin nr. 10 138, datë 11.05.2009 “Për Shëndetin Publik”.

### KREU I

#### DISPOZITA E PËRGJITHSHME

##### Neni 1

##### Qëllimi

- a) Kodi i Etikës është një bashkësi parimesh dhe rregullash që duhet të respektohet nga punonjësit e ISHP-së: kërkues, staf teknik dhe administrativ.
- b) Kodi i Etikës vendos rregullat e sjelljes së punonjësve të ISHP-së, sipas standarteve të kërkua, t'i ndihmojë ata për arritjen e këtyre standarteve dhe të vërë në dijeni publikun për sjelljen që duhet të ketë punonjësi i ISHP-së.
- c) Punonjësit e ISHP-së duhet të respektojnë rregulloren e brendshme të institucionit.

##### Neni 2

##### Misioni

Misioni i Institucionit të Shëndetit Publik është përcaktuar sipas Ligjit nr. 10 138, datë 11.05.2009 “Për Shëndetin Publik”.

##### Neni 3

##### Parimet e Shëndetit Publik

Parimet bazë të shëndetit publik në Republikën e Shqipërisë janë:

- përgjegjësia kolektive për shëndetin;
- roli udhëheqës i shtetit në ruajtjen dhe përmirësimin e shëndetit të popullatës;
- shtrirja e veprimeve në tërë popullatën;
- shpërndarja e efekteve të veprimeve në mënyrë të barabartë, në të gjitha grupet e popullatës;
- përqëndrimi në përcaktuesit socialë të shëndetit;
- përqëndrimi në faktorët risk për shëndetin e popullatës, në bazë të fakteve;
- përqsja shumëdisiplinore;
- partneriteti me tërë popullatën;

#### Neni 4

#### Zbatimi

- a) Për të bërë të mundur zbatimin e Kodit të Etikës do të merren të gjitha masat për bërjen publike të tij, përfshirë këtu edhe përdorimin e website-it të ISHP-së.
- b) Shkeljet për moszbatimin e Kodit të Etikës do të monitorohen dhe do të merren masa sipas dispozitave të mëposhtme.

#### KREU II

#### MIRËSJELLJA, VESHJA DHE SIGURIA E PUNËS


#### Neni 5

#### Komunikimi dhe Sjellja

- a) Punonjësit e ISHP-së duhet të respektojnë parimet e mirësjelljes në marrëdhënie me qytetarët, eprorët, kolegët dhe vartësit, të cilët kanë për detyrë të zbatojnë këto rregulla:
  - Komunikimi i punonjësve të Ishp-së duhet të karakterizohet nga etika, mirësjellja dhe respekti i ndërsjelltë.
  - Komunikimi verbal dhe jo verbal (gjuha e trupit, gjestikulacioni, toni i zërit, mënyra e vështrimit, ruajtja e distancës fizike etj.) duhet të jetë korrekt, pa përdorur fjalor fyes apo paragjykues, për çfarëdolloj arsye apo shkaku.
  - Në mjediset e punës nuk duhet të komunikohet me zë të lartë apo të përdoren shprehje të papërshtatshme.
- b) Punonjësit e ISHP-së nuk duhet të tolerojnë ngacmimet që kryhen ndaj tyre bazuar në dallimin racial, besimin fetar, kombësinë, etninë, seksin, privatësinë, invaliditetin, gjendjen civile, apo mbi ç'do lloj lloj çështje që mbrohet nga ligjet shtetërore.
- c) Punonjësit e ISHP në procesin e komunikimit dhe vendim-marrjes duhet të respektojnë në parim hierarkinë institucionale.
- d) Punonjësit e ISHP-së mund të përdorin telefonin celular privat kur nuk pengon kryerjen e detyrave. Përdorimi i tyre gjatë takimeve dhe mbledhjeve të punës është i ndaluar.

#### Neni 6

#### Veshja dhe Paraqitja e Jashtme

 3

- a) Punonjësit e ISHP-së duhet të kenë një veshje korrekte dhe serioze brenda normave të lejueshme konform vendit të punës. Veshja duhet të përmbushë standartet e profesionalizmit dhe modestisë, duke shmangur kështu krijimin e përshtypjes së pahijshme dhe dëmtimin e imazhit të Institucionit.
- b) Personeli laboratorëve të ISHP-së duhet të respektojnë kodin e veshjes me uniformën e duhur laboratorike.
- c) Punonjësit e ISHP-së duhet të jenë të paraqitshëm higjienikisht dhe të ruajnë pastërtinë personale.
- d) Punonjësve të ISHP-së nuk ju lejohen veshjet si: kanatjere me rripa të hollë, funde/fustane të shkurtra, pantallona të shkurtra, veshje ekstravagante që ekspozojne format e trupit (strece, pantallona të grisura, syzet e diellit dhe kapelet në ambientet e punës, këmishat e hapura, shapka, thonjët e gjatë specifikisht për punonjësit e laboratorit, bizhuteritë e mëdha etj).

#### **Neni 7**

#### **Ndalimi i Pijeve Alkoolike dhe Substanca të Tjera**

Punonjësit e ISHP-së duhet të mos përdorin substanca alkoolike, duhan, apo substanca narkotike të llojeve të ndryshme gjatë orarit të punës në ambientet e brendshme të institutit.

#### **Neni 8**

#### **Siguria në Punë**

- a) Punonjësit e ISHP-së duhet të respektojnë rregulloren e brendshme dhe standartet e laboratorëve përkatës, si ato të sigurisë së lartë dhe ambientet nëpër departamente.
- b) Punonjësit e ISHP-së ndalohen të komunikojnë me zë të lartë brenda ambienteve të institutit që sjell shqetësim dhe pengon procesin e punës në kushte normale.


### **KREU III**

#### **KONFLIKTET E INTERESAVE**

#### **Neni 9**

#### **Shmangia e Konfliktit të Interesave**

- a) Punonjësit e ISHP-së duhet të mos lejojnë që interesat e tyre private të bien ndesh me pozitën e tyre publike, të shmangin konfliktet e interesave dhe të mos shfrytëzojnë asnjëherë pozitën për interesat e tyre private.
  - Shmangia e konfliktit të interesave bëhet në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative.



- b) Punonjësit e ISHP-së lejohen të marrin pjesë në veprimtari sindikale ose të përfaqësimin të punëmarrësve, si dhe në veprimtari të mësimdhënëse, kur ato nuk pengojnë në kryerjen e detyrës.

#### **KREU IV**

### **KONFIDENCIALITETI, MEDIA DHE E DREJTA E AUTORIT**

#### **Neni 10**

##### **Konfidencialiteti**

- a) Punonjësit e ISHP-së duhet të ruajnë konfidencialitetin e informacionit që kanë në zotërim, por pa cenuar zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga Ligji nr. 8503, datë 30.06.1999 “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentat Zyrtare”.
- b) Punonjësit e ISHP-së duhet të ruajnë konfidencialitetin e të dhënave personale bazuar mbi Ligjin nr. 8517, datë 22.07.199 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.
- c) Punonjësit e ISHP-së pas largimit nga detyra nuk duhet ta përdorin informacionin konfidencial të marrë gjatë kryerjes së detyrës për interes personal.

#### **Neni 11**


##### **Marrëdhëniet me Median dhe Publikimet**

- a) Punonjësit e ISHP-së ndalohen të bëjnë deklarime, shkrime apo publikime që dëmtojnë apo denigrojnë imazhin e ISHP-së apo të personelit të saj pa fakte, në të mirë të interes të gjerë të publikut.
- b) Punonjësit e ISHP-së lejohen të bëjnë deklarime në median e shkruar, vizive dhe elektronike, në bazë të informimit të publikut për funksionet bazë të ISHP-së dhe rolit të saj mbi sëmundshmërinë dhe masat parandaluese për shëndetin e popullatës në përputhje me Ligjin nr.10 138, datë 11.05.2009 “Për Shëndetin Publik”.

#### **Neni 12**

##### **E drejta e Patentave dhe Autorit**

- a) Punonjësit e ISHP-së duhet të respektojnë ligjet në fuqi për të drejtën e patentave dhe autorit shpallur me Ligjin nr. 5825, datë 29.07.2008 “Mbi Pronësinë Industriale”
- b) Nëse një punonjës shkel normat e së drejtës së autorit, detyrohet të dëmshpërblejë mbajtësit e së drejtës.




**KREU V**  
**DHURATAT DHE FAVORET**  
**Neni 13**

- a) Punonjësit e ISHP-së nuk duhet të kërkojë apo të pranojë, në mënyrë të drejtëpërdrejtë a të tërthortë, për veten, familjen, të afërmit, personat fizikë apo juridikë me të cilët ka marrëdhënie:  
Dhurata, favore, pritje apo çdo përfitim tjetër, si dhe premtime për to, të cilat i jepen për shkak të pozicionit të tij, me efekt përfitimi të çfarëdoshëm për dhuruesin ose persona të tretë, që ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në paanshmërinë e kryerjes së detyrës, a janë ose duket sikur janë shpërblim për mënyrën e kryerjes së detyrës.
- b) Punonjësit e ISHP-së nuk duhet të kërkojnë, në mënyrë të drejtëpërdrejtë ose të tërthortë, të japin dhurata ose të ndërmjetësojnë për të dhënë dhurata për një punonjës të një niveli më të lartë apo të afërmë të tij dhe as të kërkojë ose të pranojë dhurata nga punonjës I një niveli më të ulët ose të afërm të tij, për shkak të cilësive he raporteve zyrtare.
- c) Punonjësit mund të pranojnë dhurata nga oraganizata ndërkombëtare, brenda kufijve normal të shprehjes së mikpritjes, nëse nuk tejkalohen kufijtë e traditës dhe zakoneve të vendit ku jepen, nuk vënë në dyshim objektivitetin, ndërshmërinë dhe paanshmërinë e punonjësit dhe nëse nuk kompromentojnë imazhin dhe integritetin e Institutit të Shëndetit Publik.
- d) Punonjësit e ISHP-së mund të mbajnë dhurata të lejueshme, pa qenë të detyruar ti deklarojnë ato, nëse nuk e kalojnë vlerën prej 10 000(dhjetë mijë) lekësh për dhuratë. Nëse punonjësi ka dyshim për vlerën e dhuratës, ai njofton eprorin direct dhe i kërkon njësisë së burimeve njerëzore të kryejë vlerësimin e saj.
- e) Në asnjë rast punonjësit nuk duhet të pranojnë dhurata në vlerë monetare dhe janë të ndaluara të gjitha dhuratat që çojnë në konflikt interesi sipas legjislacionit në fuqi, pavarësisht vlerës së tyre.

**KREU VI**  
**KOHA E PUNËS DHE MASAT DISIPLINORE**

**Neni 14**  
**Koha e Punës**

- a) Hyrja dhe dalja në ambientet e vëndit të punës nga punonjësit e Institutit kryhet në përputhje me orarin zyrtar të përcaktuar në kontratën individuale të punës, me përjashtim të rasteve kur për arsye objektive, autorizohet ndryshe nga titullari i institucionit.



- b) Punonjësit e ISHP-së duhet të përdorin kohën e punës në mënyrë efektive për realizimin e detyrave zyrtare. Kjo kohë nuk përdoret për asnjë qëllim tjetër, përveçse në rastet kur përdorimi i saj për qëllime të tjera është i autorizuar zyrtarisht në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- c) Punonjësit e ISHP-së që marrin pjesë në aktivitete, mbledhje, konferencë, takim pune etj, jashtë vendit apo jashtë qytetit, informojnë me shkrim eprorin direkt, titullarin e institucionit dhe njësinë e burimeve njerëzore në rrugë protokollare.

## Neni 15

### Masat Disiplinore

- a) Punonjësit e ISHP-së që shkelin parimet e etikës të përcaktuara në këtë kod etike, kur veprimet e tyre nuk përbëjnë vepër penale, ndëshkohen me masat disiplinore sipas procedurës së përcaktuar me legjislacion për statusin e nëpunësit civil.
- b) Punonjësit e ISHP-së që thyejnë disiplinën në punë ndëshkohen me këto masa sipas Kodit të Punës:
  - Vërejtje me gojë për pushim ose largim nga puna.
  - Dy vërejtje me shkrim me paralajmërim për pushim ose largim nga puna.
  - Largim nga puna.

Me thyerje të disiplinës në punë kuptojmë largimet pa leje për punë personale gjatë orarit të punës, ose krijon dëm ekonomik si rezultat i mungesave pa arsye.

## Neni 16

### Hyrja ne Fuqi

- a) Ky kod i etikës hyn në fuqi në përputhje edhe me rregulloren e brendshme që mund të ndryshojë në të ardhmen, sipas nevojave dhe interesave të shprehura nga palët e interesuara dhe me miratim të drejtorit të ISHP-së.
- b) Ky kod i etikës hyn menjëherë në fuqi me miratimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

